



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2019:139835

Datë: 14.08.2020

Numri i dokumentit: 01063762

P.nr.143/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me sekretaren juridike Shere Desku, në çështjen penale kundër të pandehurit N. (P.) GJ. K Klinë, për shkak të veprës penale „Vjedhje e shërbimeve“, nga neni 314 par 1 lidhur të KPRK-së, i akuzuari sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/IL.Nr.1013/2019, të dt. 27.06.2019, në shqyrtimin fillestar e publik të mbajtur në praninë e Prokurori i Shtetit Arben Hoti, nga Prokuroria Themelore në Pejë dhe të pandehurit të lartëcekur, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më dt. 11.08.2020, shpalli aktgjykimin, ndërsa me datën, 14.08.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: N.ë GJ. i lindur, ... K Klinë, i martuar baba i 7 fëmijëve, i biri i P. dhe nënës P., e gjinisë P., ka te kryer shkollën fillore 4 klase she, me profesion Bujk, pensionist, së gjendjes së dobët ekonomike, identifikohet me nr. personal;... shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës mbrohet ne liri

ËSHTË FAJTORË

Më datë dt. 05.10. 2017 K.Klinë, saktësisht në shtëpinë e tij, pa autorizim të furnizimit të autorizuar duke penguar njehsorin në regjistrimin e energjisë elektrike, në atë mënyrë që ditën kritike përgjatë kontrollit që kanë bërë komisioni i autorizuar i K...-it, Distribucioni në Pejë është konstatuar se tek shtëpia e të pandehurit është hasur në njehsor të bllobuar i cili është i ndaluar pasi qe ndërprerësi 0,12 furnizonte shtëpinë jashtë njehsorit elektrik ashtu që në mënyrë të kundërligjshëm ka shpenzuar energjinë elektrike,, me ç'rast të dëmtuarës K...-it i ka shkaktuar dëmin material në shumë prej 764,00 Euro.

Me çka ka kryer vepër penale, vjedhje e shërbimeve, nga neni 314 të KPRK-së

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4,7,17,41, 46, 50, 51,52 dhe 73 si dhe nenit 314, të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së:

G J Y K O N

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarin: N.ë GJ., ashtu që i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

II.LIROHET:I pandehuri nga shpenzimet procedurale për shkak të gjendjes së varfër ekonomike..

III.UDHËZOHET: Pala edëmtuar „K...’’- Distribucioni në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me Aktakuzë PP.II.Nr.1031/19, të dt.27.06.2019, ka akuzuar N. GJ. nga fshati K Klinë, për shkak të veprës penale, „Vjedhje e shërbimeve’’, nga neni 314 të KPRK-së.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 11.08.2020, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurorja e shtetit Ersan Qavolli nga Prokuroria Themelore në Pejë, dhe i akuzuari N.ë GJ..

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar, është deklaruar se e fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, sipas aktakuzës dhe ka shtuar se kërkoi falje dhe premtoj se një gjë e tillë nuk do të përsëritet, meqë është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin, kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj dënim më të butë.

Prokurori e Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë, në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë pasi që pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije të plotë për pasojat e pranimit të fajësisë, pasi që ky pranim është bërë konform dispozitave të KPPRK-së, neni 248.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht, me liri të plotë nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuar nga Prokurorja e Shtetit.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht Prokurori i shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248, par.1, të KPPRK-së dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj Gjykata konform nenit 248, par.4, të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale: vjedhje e shërbimeve, nga neni 314 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpallë fajtorë dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në llojin dhe masën e dënimit, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i pandehuri, gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, faktin se është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin, gjendjen e varfër ekonomike-familjare, është i moshës së shtyrë, duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë penale ndërsa rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, par.1, të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur, duke marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, aprovoj aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë, për dhënien e dënimit meritor, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Konform nenit 453, par.1, të KPRK-së, gjykata e obligon të akuzuarin që të kompensoj shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463, par.1 dhe 2, të KPRK-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, dhe konform dispozitave ligjore të nenit 25, par.2, 26, par. 2, 297, dhe 365 dhe 470 të KPRK-së .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA KLINË
Departamenti i Përgjithshëm Penal
P.nr. 143/2019, me dt. 14.08.2020

Sekretare juridike
Shere Desku

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet
Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e
pranimit të njëjtë, Gjykatës së Apelit në
Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.